

dialogu qeveridorë

Buletin Informativ – Prill 2011, Botimi nr. 49

Përpjekje e përbashkët e Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj dhe Sekretariatit Teknik të Donatorëve

www.dsdc.gov.al

www.aidharmonisation.org.al



Foto: (nga e majta në të djathtë) Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Tiranë, Ambasadori Eugen Wollfarth; Ministri i Drejtësisë, Bujar Nishani; Ambasadori i SHBA-së, Alexander A. Arvizu; Prokurorja e Përgjithshme, Ina Rama; Kryetari i Delegacionit të BE-së, Ambasadori Ettore Sequi; dhe Ministri i Brendshëm në detyrë, Avenir Peka në mbledhjen plenare të Konsorciumit Ndërkombëtar

Mbledhje plenare e Konsorciumit Ndërkombëtar

Konsorciumi Ndërkombëtar, grupi bashkërendues që përfshin ambasada, misione ndërkombëtare dhe organizata joqeveritare që ofrojnë asistencë në fushën e zbatimit të ligjit dhe shtetit të së drejtës në Shqipëri, organizoi takimin e përvitshëm më 19 prill 2011 me temë “Adresimi i rekomandimeve të Opinionit të Komisionit Evropian për Shqipërinë”. Ministri i Drejtësisë, Bujar Nishani, Ministri i Brendshëm në detyrë, Avenir Peka dhe Prokurorja e Përgjithshme, Ina Rama, falënderuan Konsorciumin Ndërkombëtar për kontributin e dhënë për promovimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri, nënvizuan rëndësinë e angazhimit të vazhdueshëm të Konsorciumit Ndërkombëtar për të përmirësuar efektshmërinë e asistencës ndërkombëtare në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme dhe rikonfirmuan bashkëpunimin e tyre. Ambasadori i SHBA-së, Alexander A. Arvizu, Kryetari i Delegacionit të BE-së, Ambasadori Ettore Sequi dhe Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasadori Eugen Wollfarth nënvizuan se donatorët po ndihmojnë Shqipërinë me ndërtimin, rikonstruktimin dhe pajisjen e godinave gjyqësore, penitenciare e policore, me investimin në njerëz përmes programeve të trajnimit, forcimit të kapaciteteve dhe asistencës në teknologji informacioni, me qëllim

rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve në këtë sektor. Ata nënvizuan rëndësinë e asistencës së donatorëve dhe theksuan përgjegjësinë e qeverisë shqiptare për ta përdorur këtë asistencë në mënyrën e duhur. Gjithashtu, pohuan angazhimin e tyre për zbatimin e masave dhe programeve konkrete për të përmirësuar sektorin e drejtësisë në Shqipëri. Ministri Nishani, Ministri në detyrë Peka dhe Prokurorja e Përgjithshme Rama, paraqiten një tablo të zhvillimeve, nismave dhe sfidave të sektorin, duke vënë në pah rolin e rëndësishëm të reformave të këtij sektori në përgatitjen e Shqipërisë për anëtarësim në BE. Ata theksuan se qeveria është e angazhuar që të vazhdojë të jetë partner serioz në të gjitha projektet e donatorëve që kontribuojnë në forcimin e agjencive të zbatimit të ligjit në Shqipëri. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Hysni Burgaj, vuri në dukje që qeveria ka hartuar dhe ka miratuar një plan veprimi për zbatimin eficient të 12 rekomandimeve të KE-së. Ai shtoi se Policia e Shtetit po zbaton pjesën e këtij plani veprimi që përfshin rekomandimet që janë objekt i punës së policisë.

Prezantimet e Grupeve të Punës të Konsorciumit Ndërkombëtar për çështje kyçe që lidhen me zbatimin e prioritetëve të Planit të Veprimit, u moderuan nga zv.Kryetari i

Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Dan Redford dhe paraqiten situatën në lidhje me: *Imuniteti Kushtetues dhe Reforma e Kodit të Procedurës Penale - përparimi drejt aderimit në BE; Hetimi, identifikimi dhe sekuestrimi i pasurive që rrjedhin nga veprimtari kriminale; Përmirësimi i kapaciteteve profesionale dhe logjistike të Drejtorisë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve; Forcimi i të drejtave të të miturve dhe ulja e kohës së ndalimit; Trajtimi i të ndaluarve me probleme të shëndetit mendor në sistemin penitenciar; Roli i trajnimit të Policisë së Shtetit në adresimin e rekomandimeve të Opinionit të KE-së për Shqipërinë; Përmirësimi kulturës së menaxhimit, faktor kyç në zbatimin e suksesshëm të filozofisë së Policimit në Komunitet; Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) - Bashkëpunimi, Angazhimi Financiar dhe Metrika - përparimi dhe përdorimi i Teknologjisë së Informacionit në mbështetje të objektivave të aderimit në BE. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për sfidat e ardhshme të bashkërendimit të donatorëve në këtë sektor, roli i Konsorciumit dhe riorganizimi i grupeve të punës të Konsorciumit. Mbledhja vjetore për vitin 2011 u bashkëfinancua nga Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe IC-ITAP-Departamenti i Drejtësisë i SHBA-së.*

Në këtë numër:

- Mbledhje plenare e Konsorciumit Ndërkombëtar
- Kryetari i OSBE-së dhe Ambasadori holandez vizitojnë Kuvendin, për të shënuar një moment historik në projektin për mbështetjen e parlamentit
- Takim konsultativ KE-Shqipëri për 12 rekomandimet e KE-së
- Nëpunësit civilë përfundojnë programin për Mësim dhe Zhvillim Profesional
- Ministria e Financave lançon projektin për përmirësimin e raportimit financiar të shoqërive
- USAID paraqet projektin e ri për mbështetjen e reformave në shëndetësi
- Banka Botërore ndihmon Shqipërinë në përmirësimin e mbrojtjes sociale dhe financimin e shëndetësisë
- Programi italo-shqiptar për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM): Nënshkruhet Marrëveshja e Pjesëmarrjes në Fondin Shqiptar të Garancisë
- Projekti “Rritja e rolit të grave në qeverisje”
- Mbështetja e donatorëve për zgjedhjet vendore
- Takimi i fundit konsultativ për rishikimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë gjinore, dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje
- Rinia e Kukësit tashmë më tepër mundësi punësimi
- Grant për sipërmarrjet mikro në Shkodër dhe Lezhë
- Veprimtari krentuese të Ditës Ndërkombëtare të Romëve dhe Ditës Botërore të Shëndetit
- USAID zhvillon sipërmarrjen në turizëm



■ Foto: Ambasadori holandez Henk van den Dool, Kryetarja e Kuvendit Jozefina Topalli dhe Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Tiranë, Ambasadori Eugen Wollfarth, flasin për median në evenimentin që shënon përmbylljen e mbështetjes së Vendeve të Ulëta për projektin që mbështet parlamentin dhe që zbatohet nga Prezenca e OSBE-së.

Kryetari i OSBE-së dhe Ambasadori holandez vizitojnë Kuvendin, për të shënuar një moment historik në projektin për mbështetjen e parlamentit

Më 5 prill 2011 Kryetari i Prezencës së OSBE-së Shqipëri, Ambasadori Eugen Wollfarth dhe Ambasadori i Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, Henk van den Dool, vizituan Kuvendin shqiptar. Ata u pritën nga Kryetarja e Kuvendit, Jozefina Topalli, duke shënuar përfundimin e fazave të financuara nga Holanda (2002-2010) të projektit në mbështetje të parlamentit zbatuar nga Prezenca e OSBE-së. Kryetarja Topalli e vlerësoi projektin për ndihmën që ka dhënë në rritjen e transparencës dhe efikasitetit të veprimtarive të Kuvendit. Ajo tha se kjo ndihmë ka çuar në shndërrimin e Kuvendit në model transparence dhe modernizimi për të gjithë institucionet e vendit. Veprimtaritë e projektit përfshinin rritjen e njohurive të personelit të Kuvendit për procesin e integritetit në BE dhe marrëdhëniet mes legjislacionit shqiptar dhe *acquis* të BE-së, si edhe konsolidimin e aftësive të menaxhimit, përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe të gjuhës angleze. Projekti kishte si synim forcimin e infrastrukturave parlamentare dhe përmirësimin e komunikimit midis Kuvendit dhe publikut. Biblioteka e Kuvendit u pasurua me rreth 500 tituj të rinj dhe u krijuan hapësira të reja leximi dhe studimi si për deputetët, ashtu edhe për punonjësit e Kuvendit. Në kuadër të projektit u instalua edhe një rrjet i teknologjisë së infor-

macionit i cilësisë së lartë, i cili përmbush standardet e parlamenteve të tjera evropiane. Ky rrjet i mundëson Kuvendit të transmetojë seancat plenare në internet, si dhe të vërë në dispozicion transkriptimin fjalë-për-fjalë të seancave dhe procesverbalet e komisioneve të përhershme shumë shpejt pas mbajtjes së mbledhjeve dhe seancave dëgjimore.

Ambasadori Wollfarth deklaroi gjatë vizitës së mbështetja e Prezencës së OSBE-së për Kuvendin do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2011, duke u përqendruar në forcimin dhe modernizimin e strukturave të larta të menaxhimit dhe vendimmarrjes, promovimin e transparencës dhe saktësisë së informimit, forcimin e rolit pjesëmarrës të deputetëve dhe grupeve të interesit përmes përmirësimeve të Rregullores dhe ndihmës për komisionet e përhershme, si dhe në lehtësimin e bashkëpunimit rajonal në nivel deputetësh dhe punonjësish. Prezenca e OSBE-së ka realizuar veprimtari që mbështetnin modernizimin e Kuvendit shqiptar që nga muaji janar i vitit 2002.

Takim konsultativ KE-Shqipëri për 12 rekomandimet e KE-së

Në datat 29-30 mars u organizua takimi konsultativ dyditor KE-Shqipëri për të diskutuar rreth Planit të Veprimtarive të hartuar nga autoritetet shqiptare për plotësimin e 12 rekomandimeve të Opinionit të KE-së për aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim në BE. Në fjalën e hapjes, Ministria e Integritetit, Majlinda Bregu, ritheksoi angazhimin e qeverisë për zbatimin e rekomandimeve të KE-së dhe deklaroi se fryma bipartizane për ad-

resimin e këtyre çështjeve do të ndihmojë në konsolidimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri. Ministria nënvizoi rëndësinë e përfaqësjes bipartizane për këto rekomandime të KE-së, çka shprehet në arritjen e shumicës së cilësuar në parlament. Zv.Drejtori i Përgjithshëm i Zgjerimit, Stefano Sannino, tha se Planin e Veprimit ndihmon zbatimin e rekomandimeve të KE-së dhe se takimet në këto dy ditë kanë dhënë një tablo të qartë të punës teknike që është bërë për adresimin e çështjeve kyçe. Ai gjithashtu foli për kompleksitetin e procesit të integritimit evropian dhe për nevojën e mbështetjes dhe bashkëpunimit të të gjithë aktorëve kryesorë. Grupet e punës të ngarkuara me zbatimin e veprimtarive të parashikuara në Planin e Veprimit, paraqitën një raport për ecurinë e zbatimit deri më sot.

Takimi konsultativ KE-Shqipëri për Planin e Veprimit që adreson 12 rekomandimet e Opinionit të KE-së u mbyll me një konferencë të përbashkët shtypi të Komisionerit të BE-së, Štefan Füle dhe të përfaqësuesve të qeverisë shqiptare. Duke folur për progresin e bërë me reformat kyçe, Komisioneri Füle tha se ka ardhur koha që afrimi me BE-në të zërë vendin kryesor në agjendën politike të Shqipërisë dhe se 12 rekomandimet e diskutuara përbëjnë një kuadër të qartë për ta arritur këtë.

Nëpunësit civilë përfundojnë Programin për Mësim dhe Zhvillim Profesional

Më 1 prill 2011, tridhjetë nëpunës civilë të administratës qendrore u diplomuan në programin 9-mujor të ideuar për zhvillimin e kapaciteteve bazë në fushën e bashkëpunimit rajonal. Ky program no-



■ Foto: Komisioneri i BE për Zgjerimin dhe Politikën e Fqinjësisë Štefan Füle, Ministri i Jashtëm Edmond Haxhinasto, Zv/Drejtori i Përgjithshëm i Zgjerimit të BE Stefano Sannino, Ministria e Integritimit Evropian Majlinda Bregu dhe Deputetja e PS Ermelinda Meksi, gjatë një konference shtypi mbas seminarit konsultativ BE-Shqipëri për 12 rekomandimet e KE-së

vator u organizua në kuadrin e projektit “Mbështetje e Integruar për Decentralizimin” i financuar nga BE dhe UNDP. Projekti synon të forcojë kapacitetet kombëtare për administrimin e fondeve të pritshme të BE-së për zhvillimin rajonal dhe për zhvillimin e burimeve njerëzore (Komponenti III dhe IV i IPA-s). Këto komponentë do ta nxisin integrimin evropian sapo Shqipëria të marrë statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE. Programi për Mësim dhe Zhvillim Profesional u bazua në parimet e përgjithshme të mësimin dhe zhvillimit dhe konsistonte në tre seminare, përfshi sesione trajnimit me pesë grupe, mbështetje për mësim elektronik dhe orientim individual. Përpara vlerësimit përfundimtar të pjesëmarrësve, u organizuan seanca trajnimit përmblendhëse. Pjesëmarrësit kryen ushtrime praktike që përshtateshin me punën e përditshme në ministritë e linjës. Kjo përfaqëse demonstroi anën praktike të programit që u dha pjesëmarrësve mundësinë të zhvillojnë mendimin kritik dhe novator në punën e përditshme si edhe të rrisin vetëdijen se kontributi personal ndikon në rritjen e performancës së organizatës.

Në ceremoninë e dhënies së diplomave, zv.Ministria e Integritimit, Jorida Tabaku, u shpreh: “Kjo që kemi arritur përbën kontribut të rëndësishëm për përpjekjet tona në drejtim të integritimit evropian. Ky është fillimi i një rruge më të gjatë në fushën e zhvillimit të kapaciteteve. E rëndësishme është edhe mënyra se si i përshtatim kapacitetet dhe aftësitë tona për të adresuar sfidat e integritimit evropian në të gjitha dimensionet. Ky program është pjesë thelbësore e përpjekjeve tona për të krijuar një administratë të klasit të parë.”

Drejtori i UNDP-së për Shqipërinë, Norimasa Shimomura, përgëzoi të diplomuarit dhe tha: “Ne e promovojmë reformën e administratës publike me qëllim që institucionet të bëhen solide, përfaqësuese, reaguese dhe demokratike. Ashtu si donatorët e tjerë, edhe UNDP pret të shohë më tepër efikasitet dhe efektshmëri të administratës publike. Jemi të interesuar që të ketë më tepër transparencë dhe hapje në politikëbërje, gjë që do të rritë përgjegjshmërinë, si edhe dhënie të shërbimeve me cilësi dhe efektshmëri më të mirë.”

Duke reflektuar për suksesin e programit, Facilitues i Programit dhe



■ Foto: Drejtori i UNDP-së për Shqipërinë, Norimasa Shimomura dhe zv.Ministria e Integritimit, Jorida Tabaku, me disa nga të diplomuarit prej Programit për Mësim dhe Zhvillim Profesional



■ Foto: Pjesëmarrës të Programit për Mësim dhe Zhvillim Profesional

Eksperti i Zhvillimit të Burimeve Njerëzore, Colm McClements vuri në dukje: “Me këtë program kemi synuar të zhvillojmë aftësitë bazë, përfshi aftësinë për mësim të pavarur, çka do të përkthehet në rritje të performancës së organizatave”. Z. McClement e mbylli duke thënë: “Pjesëmarrësit kanë treguar angazhim shumë të lartë. Kjo është pjesërisht meritë e mënyrës si është konceptuar programi, por mbi të gjitha është pasqyrim i motivimit të lartë të nëpunësve civilë me të cilët kemi punuar.”

Në ceremoni u theksua që një përfaqje e tillë do të ndiqet edhe në nivel rajonal për të vazhduar më tej mësimin dhe përmirësimin e qeverisjes së nëpunësve publikë që merren me zhvillimin rajonal. Trajnimi do të ndërthuret me përgatitjen e dokumenteve të rëndësishme praktike s Strategji Zhvillimi Rajonal, Plane Investimesh dhe listë projektesh, ku përfshihen të gjithë aktorët kyçë që merren me zhvillimin në nivel rajonal. Falë këtij procesi, tashmë ka filluar bashkëpunimi ndërmjet UNDP-së dhe katër qarqeve, Beratit, Dibërës, Kukësit dhe Elbasanit.

Intervistën me z. Colm McClements, Facilitues i Programit dhe Ekspert i Zhvillimit të Burimeve Njerëzore si edhe me të diplomuarën e këtij programi, Roza Dedja, mund ta shikoni [këtu](#).

Ministria e Financave lançon projektin për përmirësimin e raportimit financiar të shoqërive

Më 13 prill 2011, Ministria e Financave shpalli zyrtarisht Projektin për Përmirësimin e Raportimit Financiar të Shoqërive. Ministria e Financave, Banka Botërore dhe Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) po punojnë së bashku në Shqipëri për të krijuar një mjedis transparent politikash dhe një kuadër efektiv institucional për raportimin financiar të shoqërive, në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare dhe me *acquis* të BE-së. Përmirësimi i raportimit financiar kontribuon në investimet e huaja direkte dhe investimet e portofolit, nxit zhvillimin e sektorit financiar dhe atij privat, si dhe lehtëson integrimin evropian. Në shpalljen zyrtare merrnin pjesë përfituesit të projektit dhe aktorë të tjerë të përfshirë në reformat e raportimit financiar të shoqërive. Në tre vitet e ardhshme, ky projekt synon harmonizimin e ligjeve dhe akteve ligjore me ato të BE-



Foto: Zv.Ministri i Financave, Nezir Haldeda dhe Ambasadorja zvicerane, Yvana Enzler në shpalljen e Projektit për Përmirësimin e Raportimit Financiar të Shoqërive

së, si edhe të rrisë njohuritë për standardet e raportimit financiar dhe nivelin e zbatimit të tyre. Gjithashtu, projekti synon të ndihmojë zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit dhe të Strategjisë të Qeverisë shqiptare për Reformën Raportimit Financiar.

Ky projekt financohet nga fondi i besimit me shumë donatorë, i administruar nga Banka Botërore, me një kontribut prej 1.25 milion EUR nga SECO dhe do të zbatohet nga Ministria e Financave. Veprimtaritë e projektit do të marrin parasysh veprimtaritë rajonale të Rrugës drejt Evropës: Programi i Reformës në Kontabilitet dhe Fuqizimit Institucional (REPARIS), ku Shqipëria është pjesëmarrëse e rëndësishme. REPARIS është program rajonal i zbatuar nga Qendra Rajonale e Bankës Botërore për Reformën e Raportimit Financiar dhe financohet nga qeveritë e Austrisë dhe Luksemburgut. Në ceremoninë e lançimit, zv.Ministri i Financave, Nezir Haldeda, u shpreh: “Qeveria e Shqipërisë dhe Ministria e Financave janë të angazhuara për reformat në mënyrë që të përmirësohet kuadri ligjor, institucionet, si edhe kultura e kontabilitetit, auditivit dhe biznesit[...] Këto reforma do të realizohen me sukses vetëm nëse e marrim përgjegjësinë që t’i çojmë vetë deri në fund dhe biem në një mendje që përmirësimi i raportimit financiar është i rëndësishëm për rritjen dhe zhvillimin e vendit”.

Zv.Drejtoresha e Bankës Botërore për Shqipërinë, znj Greta Minxhozi, shprehu mbështetjen e Bankës Botërore për zhvillimin e një mjedisi transparent dhe stimulues të biznesit. Në këtë eveniment morën pjesë Ambasadorja zvicerane, Yvana Enzler e cila përshëndeti përpjekjet e qeverisë në këtë fushë dhe nënvizoi që qeveria zvicerane është kontribuuese e rëndësishme në fondin e donatorëve

për projektet e zhvillimit ekonomik, siç është projekti i qeverisjes së mirë i zbatuar nga IFC, si edhe natyrisht ky projekt i përmirësimin të raportimit financiar të shoqërive. Rezultatet e pritura nga ky projekt janë: përmirësimi i legjitimitetit të kuadrit ligjor në fushën e raportimit financiar të shoqërive, duke e harmonizuar me *acquis* të BE-së; forcimi i vendosjes së standardeve nga ana e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit; përmirësimi i vendosjes së standardeve dhe i mbikëqyrjes së praktikave audituese nga ana e sistemit të mbikëqyrjes së auditimit; përmirësimi i aftësive për të arritur përputhshmërinë me standardet e reja profesionale përmes rishikimit dhe përditësimit të programeve të kontabilitetit dhe auditivit për universitetet dhe certifikimin profesional; dhe përmirësimi i menaxhimit të reformave në raportimin financiar të shoqërive nga ana e Komitetit Drejtues Kombëtar dhe Ministrisë së Financave. Komiteti Drejtues Kombëtar i reformës kombëtare të raportimit financiar do të ketë rol mbikëqyrës në këtë projekt, ndërsa përfituesit përfshijnë Ministrinë e Financave, Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, Bordin e Mbikëqyrjes Publike, Shoqatat Profesionale dhe Universitetet.

USAID paraqet projektin e ri që mbështet reformat në shëndetësi

Më 8 prill, USAID organizoi një konferencë për të lajmëruar fillimin e një projekti të ri në mbështetje të reformës në shëndetësi. Ambasadori i SHBA-së në Shqipëri, z. Alexander Arvizu, Kryeministri Sali Berisha dhe Ministri i Shëndetësisë, Petrit Vasili, mbajtën fjalimet përshëndetëse në këtë konferencë. Projekti

5-vjeçar i USAID-it “Mbështetje e Reformës në Shëndetësi” do të rritë aksesin në shërbimet shëndetësore bazë për njerëzit në nevojë si dhe do të mbështesë politikat kombëtare të reformave në shëndetësi. USAID do të punojë me institucionet shëndetësore në Shqipëri: për të përcaktuar më mirë rolet e tyre optimale si dhe një strukturë transparente dhe mirëqeverisëse të sistemit shëndetësor; për të krijuar kodet e sjelljes anti-korrupsion; për të zhvilluar dhe për të zbatuar masat për transparencën dhe përgjegjshmërinë; dhe për të hartuar programe për kufizimin e korrupsionit.



■ Foto: Në fjalën e tij, Ambasadori Arvizu konfirmoi mbështetjen e SHBA për përpjekjet e Qeverisë së Shqipërisë për të përmirësuar qeverisjen në këtë sektor duke ndihmuar në luftën kundër korrupsionit në shëndetësi dhe inkurajoi drejtuesit të zhvillojnë një vizion dhe strategji të qartë për zbatimin e reformave të drejta shëndetësore

Banka Botërore ndihmon Shqipërinë në përmirësimin e mbrojtjes sociale dhe financimin e shëndetësisë

Më 28 prill 2011, Bordi i Drejtorëve Ekzekutivë i Bankës Botërore miratoi paketën që synon ta ndihmojë Shqipërinë për ta përmirësuar efektshmërinë e sistemeve të mbrojtjes sociale dhe për ta rritur efikasitetin dhe barazinë e financimit të shëndetësisë. Huaja për Politikën për Zhvillim e Politikave për Reformën në Sektorin Social, një hua prej 25 milion USD, synon të mbështesë përmirësimin e programeve të asistencës sociale për të arritur më mirë të varfrit dhe të personat pa akses në shërbimet sociale bazë. Kjo paketë mbështet politikën që forcojnë mekanizmat e akordimit të fondeve dhe përzgjedhjen e përfituesve në programin kryesor të asistencës sociale; nxirr stimujt për investim në kapitalin njerëzor përmes ofrimit të një pagese sociale shtesë të lidhur me regjistrimin dhe frekuentimin e shkollës për familjet që kanë fëmijë në moshë shkollore; starton proceset për

krijimin e një regjistri të unifikuar të përfituesve prej programeve të asistencës sociale; dhe ndryshon formulën e indeksimit të programit të pagesave të invaliditetit, me qëllim që të mbahet nën kontroll vëllimi i burimeve që i jepen këtij programi, i cili po rritet në raport të zhdrejtë. Gjithashtu, kjo paketë do të rritë efikasitetin dhe barazinë e shpenzimeve për shëndetësinë, duke i bërë më të parashikueshme rregullat fiskale për financimin e shëndetësisë; do të përmirësojë metodat e kontraktimit të ofruesve të shërbimit dhe kapacitetet monitoruese të punës së tyre; dhe do t'u sigurojë sigurim shëndetësor përfituesve të asistencës sociale.

Aktualisht, Banka Botërore po financo 15 projekte në Shqipëri në sektorin social, shëndetësi, arsim, burime natyrore, ujësjellës-kanalizime dhe energjetikë, infrastrukturë komunale dhe administrimin e sektorit publik, me qëllimin që ta ndihmojë Shqipërinë të arrijë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social dhe të lehtësojë rrugën e integritit evropian.



■ Foto: Seminari “Rezistenca ndaj Antibiotikëve” e organizuar më 7 prill 2011 në Tiranë.

Dita Botërore e Shëndetit 2011

Rezistenca antimikrobiale ishte tema globale e Ditës Botërore të Shëndetit 2011. Me këtë rast, më 7 prill 2011, Zyra e OBSH-së në Shqipëri në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë, organizoi në Tiranë seminarin për Rezistencën Antimikrobiale, me qëllim që të rritet ndërgjegjësimi për rrezikun që mbart përdorimi apo keqpërdorimi i antibiotikëve në prodhimin e produkteve shtazore dhe në terapitë njerëzore, si edhe nevojën për ta trajtuar rezistencën ndaj antibiotikëve përmes një përjasjeje të plotë dhe të integruar. Në këtë seminar morën pjesë edhe përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Përfundimi i seminarit ishte se hartimi i strategjive efikase dhe të suksesshme për adresimin e rezistencës ndaj antibiotikëve kërkon bashkëpunim ndërsektorial ndërmjet autoriteteve të shëndetësisë, veterinarisë dhe ushqimit. Për këtë qëllim, u krijua Komiteti Koordinues Kombëtar në nivel ndërministror, i cili do të përcaktojë mekanizmat formalë të ndërveprimit mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe ministrive të tjera përkatëse.

Java Evropiane e Imunizimit: Zgjidhjet e përbashkëta ndaj rreziqeve të përbashkëta - popullsitë vulnerabël në Evropën Juglindore

Më 28-29 prill 2011, u organizua në Tiranë konferenca e vendeve të Evropës Juglindore me pjesëmarrës nga Bullgar-

ia, Greqia, Kroacia, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia, Bosnja-Hercegovina, Kosova e Shqipëria, si edhe nga OJF rome nga Shqipëria. Ky eveniment u mbajt në kuadrin e Javës Evropiane të Imunizimit dhe u mbështet nga OBSH dhe UNICEF. Qëllimi i Javës Evropiane të Imunizimit është të rritë ndërgjegjësimin për rëndësinë e imunizimit si edhe të shtojë shtrirjen territoriale të vaksinimit. Vëmendje e veçantë i kushtohet veprimtarive që kanë në fokus popullsitë vulnerabël. Konferenca synonte të krijohej një platformë e përbashkët rajonale që përmban praktikën dhe zgjidhjet më të mira nga vendet e Evropës Juglindore në lidhje me kontrollin dhe parandalimin e përhapjes apo rishfaqjes të sëmundjeve që parandalohen me vaksina. Në fjalën e tij, Ministri i Shëndetësisë, Dr. Petrit Vasili deklaroi: “Ne synojmë t’u ofrojmë të gjithëve shërbime cilësore imunizimi dhe të eliminojmë pabarazitë në përhapjen e sëmundjeve të parandalueshme me vaksina”.



Foto e bërë gjatë konferencës së Evropës Juglindore me rastin e Javës Evropiane të Imunizimit

Programi italo-shqiptar për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM): Nënshkruhet Marrëveshja e Pjesëmarrjes në Fondin Shqiptar të Garancisë

Më 26 prill 2011, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Nasip Naço dhe shtatë përfaqësues të bankave kryesore tregtare në Shqipëri (BKT, Rafaisen Bank, Credins Bank, Veneto Bank, Tirana Bank, ICB, NBG) nënshkruan zyrtarisht marrëveshjen e pjesëmarrjes në Fondin Shqiptar të Garancisë, nën drejtimin e Ambasadorit të Italisë në Shqipëri, Saba D’Elia dhe drejtorit të Kooperacionit

Italian për Zhvillim, Aldo Sicignano.

Fondi Shqiptar i Garancisë i financuar nga Kooperacioni Italian për Zhvillim me një kontribut prej 2.5 milion eurosh përbën objektivin e dytë më të rëndësishëm të arritur nga Programi italo-shqiptar për Zhvillimin e NVM-ve dhe ka aktualisht dy komponentë aktivë: një linjë kreditimi prej 25 milion eurosh dhe asistencë teknike prej 1.7 milion eurosh. Që në 2009, linja e kreditimit ka financuar 46 projekte investimesh të NVM-ve me 11 milion euro në total të lëvruara për blerjen e teknologjisë italiane. Fondi i Garancisë synon të lehtësojë aksesin e NVM-ve në huamarrje dhe të zhvillojë investimet produktive. Ministri Naço përshëndeti arritjet e Programit për Zhvillimin e NVM-ve shqiptare dhe falënderoi Qeverinë italiane dhe bankat pjesëmarrëse për angazhimin e tyre. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, përfaqësuesit e bankave demonstruan angazhimin e tyre për të nxitur zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Drejtori i përgjithshëm i BKT-së, e cila deri më sot ka financuar gjysmën e projekteve të investimeve, nënvizoi nevojën për nisma të tilla për të mbështetur zgjerimin e bizneseve dhe konkurrueshmërinë në tregjet shqiptare dhe ndërkombëtare. Në fjalimin e tij, Ambasadori italian Saba D’Elia u shpreh se nënshkrimi i marrëveshjes së

pjesëmarrjes në Fondin e Garancisë është një moment historik i Programit për Zhvillimin e NVM-ve shqiptare, si dhe konfirmoi se angazhimi i Italisë në zhvillimin e sektorit privat do të vazhdojë edhe në vijimet në vijim, dhe se nismat e reja akordojnë një shumë totale prej 15 milion euro, kryesisht në sektorin e agro-biznesit, siç përcaktohet në Protokollin e Bashkëpunimit Dypalësh italo-shqiptar 2010-2012. Lançimi zyrtar i marrëveshjes për Fondin Shqiptar të Garancisë dhe zbatimi i nismave të ardhshme tregon qartë përkushtimin e Italisë si donatori kryesor evropian për zhvillimin e sektorit privat.

Projekti “Rritja e rolit të grave në qeverisje”

Më 8 prill 2011, Presidenti i Republikës, Bamir Topi, mori pjesë në ceremoninë e diplomimit të grave që përfunduan një projekt trajnimi për zgjedhjet vendore. Veprimtaritë trajnuese u realizuan në kuadrin e projektit të zbatuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri “Rritja e Rolit të Grave në Qeverisje”, i financuar nga qeveritë e Suedisë dhe Holandës. Trajnimi u shtri në të gjithë vendin dhe mbledhi nga shumë shtresa dhe qytete. Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Tiranë, Ambasadori Eugen Wollfarth, u dorëzoi certifikatat rreth 200 grave, shumica e të cilave ishin candidate në listat partiake. “Heqja e hendekut aktual të barazisë gjinore në të gjitha strukturat qeverisëse mbetet një sfidë. Të gjithë partnerët vendas dhe ndërkombëtarë kanë një përgjegjësi thelbësore për ta trajtuar këtë çështje”, tha Wollfarth. Ai shtoi se zgjedhjet e 8 Majit do të tregojnë se në ç’skallë gratë do të votojnë dhe në ç’nivel do të jenë në gjendje ta bëjnë këtë në mënyrë të fshehtë dhe individuale. Presidenti Topi deklaroi: “Në ditët e sotme, paragjykimi gjinor dhe praktikën diskriminuese administrative dhe juridike që pengojnë barazinë ligjore nuk ekzistojnë



Foto: Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Nasip Naço, Ambasadori i Italisë në Shqipëri, Saba D’Elia dhe drejtorit të përgjithshëm të bankave në ceremoninë e nënshkrimit të Marrëveshjes së Pjesëmarrjes në Fondin Shqiptar të Garancisë më 26 prill 2011

më. Fatkeqësisht, ka akoma një hendek të madh mes premtimeve të partive politike për të rritur pjesëmarrjen e grave në procesin vendimmarrës dhe në listat e kandidatëve”. Ndërsa Këshilltarja e Ambasadës suedeze dhe shefja e Sida-s në Shqipëri, Britta Olofsson, u shpreh: “Ka akoma një mospërputhje mes vullnetit politik dhe zbatimit në praktikë të angazhimeve në Shqipëri”. Ajo shtoi se përfaqësimi politik nuk është vetëm meritë dhe aftësi, por është përfaqësim i njerëzve dhe gratë kanë të drejtën e përfaqësimit të barabartë si të gjithë qytetarët”. Ky eventiment përmbylli fazën e dytë të këtij projekti trevjeçar.



Foto: Ceremonia e diplomimit të grave që përfunduan projektin e trajnimit për kandidatet femra në zgjedhjet vendore

Takimi i fundit konsultativ për rishikimin e Strategjisë Kombëtare për barazinë gjinore, dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje

Më 1 prill 2011, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta organizoi takimin e fundit konsultativ për prezantimin formal para grupeve

të interesit të draftit të Strategjisë kombëtare për barazinë gjinore, dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje 2011-2015 të rishikuar. Gjatë prezantimit të strategjisë, zv.Ministria Filloreta Kodra falënderoi veçanërisht UN Women dhe UNDP si partnerët kryesorë mbështetës të procesit që prej pothuaj një viti. Pjesëmarrësit vlerësuan MPCSSH-bë për garantimin

e një procesi unik, të hapur dhe pjesëmarrës si edhe për reflektimin e sugjerimeve dhe kontributit të shoqërisë civile në draftin e rishikuar. Nisma për rishikimin e strategjisë 2007-2010 mori jetë nga nevoja për të përputhur afatet kohore me ato të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim si edhe për t'iu përgjigjur zhvillimeve dhe kërkesave për forcimin e

Zëri i Fëmijëve është në Votën Tuaj

Zëri i Fëmijëve është në Votën Tuaj ishte slogani i fushatës publike sensibilizuese të lançuar nga shoqëria civile gjatë prillit 2011, në përpjekje për të fokusuar vëmendjen zgjedhore te çështjet e fëmijëve në kohën kur qytetarët shqiptarë u bënë gati të hedhin votën në zgjedhjet e 8 majit. Fëmijët përbëjnë rreth 1/3 e popullsisë së Shqipërisë. Edhe pse nuk mund të votojnë, interesi i fëmijëve në politikën vendore mund të përfaqësohet nga vota e të rriturve. “Terre des hommes” në Shqipëri, bashkë me BKTF (Bashkë për Kujdesin Tërësor të Fëmijëve) dhe me mbështetjen e UNICEF-it dhe të partnerëve të projektit Zhvillimi i Rrjetit të Mbrojtjes së Fëmijëve (CPSN), përgatitën dhe shpërndanë mijëra fletëpalosje në të gjithë vendin për të informuar qytetarët për situatën aktuale si edhe për zhvillimet në lidhje me respektimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Fletëpalosja nxiste ë gjithë votuesve të diskutonin aktivisht për ngurrimin e pushtetit vendor për të ofruar shërbime për fëmijëve dhe krijimin e komuniteteve miqësore për fëmijët. Votuesve u bëhej thirrje që të shtynjë dhe t'iu bëjnë pyetje specifike kandidatëve gjatë fush-



Fletëpalosje e përgatitur nga “Terre des hommes” bashkë me Koalicinin BKTF (Bashkë për Kujdesin Tërësor të Fëmijëve) me mbështetjen e UNICEF-it dhe të partnerëve, për të informuar qytetarët për situatën aktuale, si edhe për zhvillimet në lidhje me respektimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

atës zgjedhore që të garantohen të drejtat e fëmijëve dhe përfshirja e mbrojtjes së fëmijëve në programet e tyre zgjedhore. Fëmijët në qarqe të ndryshme të vendit kanë arritur të organizojnë aktivitete avokatimi me moshatarët, prindërit, pjesëtarët e komunitetit dhe kandidatët vendore për çështjet me interes për ta. Mesazhet e tyre iu parashtruan kandidatëve zgjedhorë në formën e kërkesave specifike dhe premtimeve që supozohet të mbahen nga kandidatët fitues

brenda 6 muajve nga ardhja në pushtet. Në këtë kontekst, një deklaratë për shtyp që nxiste votuesit dhe kandidatët të trajtojnë me prioritet çështjet e fëmijëve gjatë zgjedhjeve vendore u publikua më 29 prill 2011 nga “Terre des hommes”, Koalicioni BKTF, Ambasada e SHBA-së, Ambasada Britanike dhe Ambasada e Vendeve të Ulëta. Pushteti vendor është një nga aktorët kryesorë në këtë proces, pasi janë përgjegjës për krijimin, mbështetjen dhe zbatimin e shërbimeve vendore për të gjithë fëmijët, sidomos për fëmijët në nevojë, në rrezik abuzimi, neglizhence, shfrytëzimi dhe/ose trafikimi. Për më tepër, pushteti vendor mund të garantojë që interesat dhe zëri i fëmijëve të merret parasysh në procesin e hartimit të politikave. Pavarësisht se Shqipëria e ratifikoi Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve në 1992 dhe miratoi në vitin 2010 Ligjin për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës si dhe ngriti Njësi për Mbrojtjen e Fëmijëve në 27 bashki dhe komuna, ende mbetet shumë për të bërë për zgjerimin dhe forcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve. Secili nga ne duhet të luajë rolin e vet në përmirësimin e situatës. Qytetarët shqiptarë, falë votës së tyre, do të bëjnë zgjedhjen e tyre që do të ndikojë në të ardhmen e 929 mijë fëmijëve në Shqipëri.

masave që synojnë krijimin e një shoqërie që garanton pjesëmarrje të barabartë dhe mbrojtje të të gjithë qytetarëve shqiptarë, pa asnjë dallim seksi, identiteti gjinor, (pa)aftësie, moshe apo origjine sociale. Dokumenti i rishikuar është produkt i një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës ku morën pjesë institucione të pushtetit qendror dhe vendor, shoqëria civile, OJF-të, grupe të ndryshme interesi, përfaqësues të partive politike, akademike, si edhe donatorë dhe partnerë ndërkombëtarë. Strategjia e rishikuar ka katër fusha prioritare: Forcimi i mekanizmave institucionalë e juridikë; Rritja e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje; Fuqizimi ekonomik i vajzave dhe grave; dhe Reduktimi i dhunës ndaj grave. Në prill, dokumenti do të paraqitet pranë Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore për shqyrtim dhe pastaj do të dorëzohet në Këshillin e Ministrave për miratim. Ndërkohë, po përgatitet Plani i Veprimit me kostot e veprimtarive që pritet të jetë gati në qershor.

Prezenca e OSBE-së zhvillon seminare për raportimin gjatë zgjedhjeve, në prag të zgjedhjeve vendore në Shqipëri

Para zgjedhjeve vendore të 8 majit, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri organizoi një sërë seminaresh trajnimi për gazetarët e rretheve në lidhje me raportimin e zgjedhjeve. Seminaret synonin të ndihmonin gazetarët për të rritur cilësinë e raportimeve gjatë periudhës zgjedhore. Gjatë seminarit, gazetarët në Shkodër,



Foto: Takimi i fundit konsultativ për prezantimin formal të draftit të Strategjisë kombëtare të rishikuar 2011-2015, organizuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta më 1 prill 2011

Fier, Gjirokastrë dhe Korçë u njohën më mirë me raportimin gjatë procesit zgjedhor, funksionimin e institucioneve të administrimit të zgjedhjeve dhe se si të marrin informacion lidhur me zgjedhjet. Trajnimi u zhvillua nga ekspertët Rastislav Kuzel dhe Ivan Godarsky, të cilët punojnë për MEMO 98, një organizatë jo-qeveritare sllovaqe me përvojë të gjerë në monitorimin dhe studimin e medias. Ana Tenolli, eksperte ligjore e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i njohu pjesëmarrësit me dispozitat e Kodit Zgjedhor lidhur me median.

Korça bashkon forcat për t'i dhënë fund dhunës në familje

Më 1 prill 2011, përfaqësues të bashkisë Korçë dhe strukturave të tjera vendore (si gjykatat, zyrat e përmbarrimit, prokuroria, policia, shërbimet e shëndë-

tësisë, arsimit dhe punësimit) zhvilluan një takim që të shqyrtojnë progresin e deritanishëm në ngritjen e një mekanizmi të bashkërenduar referimi për të analizuar numrin e incidenteve të trajtuara gjatë vitit të parë të bashkëpunimit si dhe për të propozuar zgjidhje afatgjata për rastet e dhunës në familje. Ekipe të ndërdisiplinore të përbëra nga specialistë të të gjitha strukturave anëtare, takohen shpesh për t'u gjetur zgjidhje nevojave të shumta dhe komplekse të të mbijetuarve nga dhuna në familje. Ata kanë ndërmarrë një sërë veprimesh, si për shembull kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi për të rregulluar strukturën e bashkëpunimit të tyre, kanë instaluar një bazë elektronike të dhënash që mënjanon numërimin dy herë të një rasti dhe që e ndjek rastin përgjatë gjithë hallkave të referimit, deri në zgjidhjen e tij përfundimtare. Ata kanë vendosur edhe një linjë telefonike falas për qytetarët që të kallëzojnë incidentet e dhunës në familje dhe kanë vendosur një koordinatore që mbështet dhe shoqëron viktimën përgjatë tranzicionit të vështirë drejt një jete pa dhunë.

Kryetari i bashkisë së Korçës, Niko Peleshi, vuri në dukje me optimizëm se mekanizmi komunitar i bashkërendimit të punës kundër dhunës në familje po funksionon mjaft mirë në Korçë dhe se rezultatet e para pozitive kanë nisur të duken. Në vitin 2010, nga 71 raste që kërkuan ndërhyrjen e autoriteteve publike, 51 janë trajtuar sipas modelit të referimit dhe bashkërendimit ndërdisiplinor. “Është e rëndësishme që një model i ngjashëm të zbatohet edhe për çështje të përfshirjes sociale, si për të rinjtë, popullsinë rome, apo personat me paaftësi”, shtoi ai. Koordinatorja e Përhershme e Kombeve të Bashkuara dhe Përfaqë-



Foto: Prezenca e OSBE-së zhvillon seminare për raportin gjatë zgjedhjeve, në prag të zgjedhjeve vendore në Shqipëri

suesja e Përhershme e UNDP-së, Zineb Touimi-Benjelloun, ndër të tjera tha: “Teksa ndërgjegjësimi i viktimave rritet, është me rëndësi që ju të forconi bashkëpunimin mes institucioneve tuaja dhe të përmirësoni reagimin e sistemit. Me angazhimin tuaj të vazhdueshëm në këtë sistem bashkëpunimi, ne kemi shpresën që Korça do të bëhet shembull për shumë qytete dhe fshatra në Shqipëri dhe të nxisë tek ato përpjekjet për të ndërtuar mekanizmin e tyre të referimit dhe bashkërendimit. Edhe pse në demokracisë është normale që drejtuesit e institucioneve të ndryshojnë vazhdimisht, si në nivel qendror ashtu edhe vendor, shteti duhet të garantojë qytetarët se do t’i përgjigjet si një trup i vetëm çdo të mbijetuar që ka nevojë për ndihmë dhe do të përndjekë cilindo dhunues që ngre dorë ndaj pjesëtarëve të familjes.” Kryetari i gjykatës nënvizoi kostot që lidhen me shqyrtimin e urdhrave të mbrojtjes. Përfaqësuesi i policisë vuri në dukje nevojën për respektimin me rreptësi të protokolleve policore dhe të mos bëhen përpjekje për pajtimin e viktimës me dhunuesin. Përfaqësuesit e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale prezantuan vështirësitë për akomodimin e të miturve të abuzuar në qendra të përshtatshme për ta. OJF-ja që administron një strehëz kundër dhunës në familje tërhoqi vëmendjen te rëndësia e bashkërendimit me programet sociale të strehimit, për t’iu garantuar të mbijetuarve mbështetje afatgjatë që të mos i kthehen marrëdhënies së dhunshme.

Nga ekzaminimi i kujdesshëm i rasteve individuale dolën zgjidhje krijuese dhe të ponderuara. Në fakt, bazuar mbi



Foto: Takimi i përfaqësuesve të bashkisë Korçë dhe strukturave të tjera vendore më 1 prill 2011

përvojën dhe informacionin e pasur nga bashkitë pilote si Korça dhe të mbështetura nga Kombet e Bashkuara, Këshilli i Ministrave miratoi në shkurt 2011 një vendim për të krijuar mekanizma të tillë bashkërendimi dhe referimi në nivelin vendor në të gjithë vendin. Me zbatimin e këtij modeli në çdo komunitet, për të mbijetuarat nevoja për t’iu drejtuar secilit prej organeve shtetërore më vete do të jetë praktikë e të kaluarës.

Mbështetja e PNUD-it për bashkërendimin dhe referimin ndaj dhunës në familje ofrohet në kuadrin e Programit të Përbashkët të OKB-së për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje (2008-2011), në bazë të të cilit, PNUD, UN Women, UNFPA dhe UNICEF ndihmojnë Shqipërinë në zbatimin e legjislationit përkatës dhe Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, Dhunën ndaj Grave dhe kundër Dhunës në Familje.

Rinia e Kukësit më tepër mundësi punësimi pas nënshkrimit të Paktit Rajonal të Punësimi

Më 15 prill 2011, përfaqësues të qeverisë, Këshillit të Qarkut Kukës, OKB-së, institucioneve publike, ofruesve të trajnimeve, sindikatave, komunitetit të biznesit dhe medias, zhvilluan u mblodhën në Kukës për të nënshkruar Paktin Territorial për Punësimin e të Rinjve të Qarkut të Kukësit. Pakti do të hapë një mijë vende pune deri në fund të këtij viti. Pakti i Punësimi përcakton rolet dhe përgjegjësitë e mbi 40 aktorëve të përfshirë në përpjekjet për formalizimin e tregut të punës në këtë qark. Ai është fryt i përpjekjeve të përqendruara në nivel vendor, nën drejtimin e Bordit Rajonal të Punësimi dhe i ndihmesës teknike të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Marrëveshja ofron një investim prej rreth 250 mijë dollarë amerikanë, nga të cilat rreth 160 mijë dollarë amerikanë janë financuar nga Kombet e Bashkuara, në kuadrin e Programit të Përbashkët të OKB-së për Punësimin dhe Migrimin e të Rinjve, ndërsa 89 mijë dollarë amerikanë janë kontribut në natyrë i partnerëve vendorë si shoqëri tregtare, sindikata dhe shoqata. Për më tepër, Pakti do të ndërthuret me skemat e granteve prej afro 300mijë dollarë amerikanë të ofruara nga qeveria shqiptare për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale të qarkut të Kukësit.

Gjatë ceremonisë së nënshkrimit, zv.Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta deklaroi: “Po fillojmë sot me rreth një mijë vende të reja pune në qarkun e Kukësit. Shpresojmë që së shpejti edhe qarqe të tjera të Shqipërisë



Foto: Zv.Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Kastriot Sulka, Kryekëshilltarja Teknikë e YEM-it (në mes), Daniela Zampini dhe Kryetari i Këshillit të Qarkut të Kukësit, Shfaqet Bruka, gjatë nënshkrimit të Paktit Territorial për Punësimin e të Rinjve të Qarkut të Kukësit

do t'i bashkohen iniciativës së Pakteve Territoriale për Punësimin e të Rinjve. Ne do ta mposhtim papunësinë dhe do të formalizojmë 100 apo 200 vende pune njëkohësisht, duke punuar e në çdo fshat të vogël të Shqipërisë, nëse është e nevojshme”. Kryetari i Këshillit të Qarkut të Kukësit dhe i Bordit Rajonal të Punësim-it, z. Shefqet Bruka, u shpreh se: “Përgatitja e Paktit Territorial për Punësimin ishte një sfidë frymëzuese dhe sigurisht jo e lehtë, por ne të gjithë besojmë fort dhe ndjehemi mirë kur mendojmë se e ardhmja për 1 000 të rinj të qarkut tonë do të jetë më e sigurt, falë punës së shkëlqyer që kemi bërë dhe që do të vazhdojmë të bëjmë në kuadrin e këtij Pakti.”

Qarku i Kukësit është mjaft i prekur nga probleme që kanë të bëjnë me migrimin e të rinjve, si nën-punësimi, puna informale në sektorin e bujqësisë që kryesisht plotëson vetëm nevojat e familjes, mungesa e trajnimeve dhe e shërbimeve për rritjen e produktivitetit, mungesa e kushteve të punës si dhe të sigurisë dhe shëndetit në punë. Për të adresuar këto sfida, me partneritetin e krijuar mes aktorëve vendorë dhe kombëtarë përmes Paktit Territorial për Punësimin e të Rinjve, puna do të përqendrohet në katër drejtime: formalizimi i sipërmarrjeve dhe punonjësve, informimi dhe rritjen e ndërgjegjësimit për emigrimin e sigurt dhe çështjet e punësimit, trajnimi i të rinjve për të qenë të aftë të punësohen dhe të sigurojnë jetesën, si dhe kryerjen e trajnimit profesionalë gjatë punës.

Programi i Përbashkët i OKB-së “Punësimi dhe Migrimi i të Rinjve: Përfundimi i dobive dhe pakësimi i rreziqeve”, që po zbatohet bashkërisht nga ILO, IOM, UNDP dhe UNICEF, synon të rrisë mundësitë e të rinjve për punë të denjë në Shqipëri dhe menaxhimin e emigrimit, duke i vendosur këto çështje në planin e prioriteteve të strategjive kombëtare për të rinjtë, punësimin dhe migrimin. Programi financohet nga Qeveria e Spanjës, nëpërmjet Fondit për Arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit për të Rinjtë dhe Migrimin.

Nënshkruesit e Paktit Territorial për Punësimin e të Rinjve në Qarkun e Kukësit janë: Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar, Shoqata e Artizanëve Shqiptarë, Shoqata për Zhvillimin e Bujqësisë (ADAD), Shoqata e Bletërritësve të Komunës Bicaj, Konfederata e Sindikatave Shqiptare, ERA catering, Komuna Golaj, Illyria Minerals Industry sh.a, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Bash-



Foto: Kryetari i Prezencës së OSBE-së, Eugen Wollfarth dorëzon certifikata fëmijëve pjesëmarrës në evenimentin kundër diskriminimit të organizuar bashkërisht me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi

kia Krumë, Dhoma e Tregtisë Kukës, Federata e Fermerëve të Kukësit, Bashkia Kukës, Zyra e Prefekturës Kukës, Projekti për Mbështetjen e Turizmit dhe Mjedisit në Qarkun e Kukësit, Këshilli i Qarkut Kukës, Qendra Linkoln, Shoqata e Sipërmarrësve në Blegtori, Komuna Malzi, Komuna Margegaj, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Financave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Qendra Lëvizëse e Arsimit dhe Formimit Publik për Zonat Verilindore, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Zyra Rajonale e Punësimit, Komuna Shishtavec, SNV Albania, Programi për Mbështetjen e Bujqësisë së Qëndrueshme për Shqipërinë, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Muzikës - Dega Kukës dhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura Shqiptare.

Prezenca e OSBE-së dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi diskutojnë mënyrat e zvogëlimit të diskriminimit në shkolla

Më 11 prill 2011, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi organizuan një takim ku diskutuan rreth mënyrave për të ulur diskriminimin nëpër shkolla. Takimi u realizua në kuadrin e bashkëpunimit të Prezencës me Komisionerin për të rritur ndërgjegjësimin për diskriminimin, veçanërisht te nxënësit dhe

mësuesit. Kryetari i Prezencës, Ambasadori Eugen Wollfarth dhe Komisionerja për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Irma Baraku, morën pjesë në këtë veprimtari dhe përruan një ekspozitë me vizatime dhe krijime poetike të nxënësve 10-15 vjeçarë mbi temën e diskriminimit. Juria përzgjedhi pesë vizatimet më të mira dhe nderoi me çmim fëmijët që i kishin realizuar. Punimet artistike do të botohen në një broshurë e cila do të shpërndahet më pas në shkollat fillore. Në takim, një psikologe paraqiti një panoramë se si fëmijët e perceptojnë diskriminimin, duke shtruar se çfarë mund të bëhet për ta pakësuar akoma më shumë diskriminimin. Dy ekspertë në fushën e anti-diskriminimit folën se si zbatohet ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” për nxënësit. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri punon për të sensibilizuar publikun për çështjet e diskriminimit. Prezenca ka ndihmuar Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi që prej shkurtit 2010 kur Kuvendi i Shqipëri miratoi ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, sidomos duke mbështetur krijimin e faqes së internetit të Komisionerit.

Romët e Korçës do të kenë zërin e tyre në media

Programet dhe operatorët mediatikë që i shërbejnë minoritetit rom janë fare të paktë. Roli i mediave vendore private në zonat me popullsi të konsiderueshme rome nuk është ndier shumë. Për ta për-

mirësuar këtë situatë, UNICEF dhe televizioni lokal TV Kristal në Korçë ranë dakord të bashkëpunojnë për të prodhuar programe televizive të cilësisë së lartë për fëmijët dhe të rinjtë romë. Prandaj, u organizua një trajnim 4-ditor gjatë datave 2-5 prill për të ndihmuar rininë romë të kuptojë aftësitë bazë të gazetarisë dhe të përfshihet më tepër në komunitet duke përdorur fuqinë e medias. TV Kristal është angazhuar të prodhojë dhe të transmetojë emisione në gjuhën romë. Me këtë rritje të aksesit në televizion, romët do të jenë në gjendje të ruajnë, të promovojnë dhe të përmirësojnë gjuhën, kulturën dhe traditën romë. Pritet që emisionet të ndihmojnë në eliminimin e stereotipeve për romët dhe të përmirësojë pozitën sociale të minoritetit rom brenda komunitetit të gjerë.

Promovimi i artizanëve romë në Ditën Ndërkombëtare të Romëve

UNDP në Shqipëri bashkoi forcat me Bashkinë e Tiranës, Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrinë e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve për të organizuar një seri eventimesh kulturore me rastin e 8 prillit, Ditën Ndërkombëtare të Romëve. Kjo ditë shërben si një mundësi për të kremtuar kulturën romë dhe për të rritur sensibilizimin për vështirësitë me të cilat përballen romët. Aktivitetet ditore të organizuara në parkun Rinia përfshinin muzikë, valle dhe interpretime tradicio-



Foto: Diskutime gjatë trajnimit të UNICEF-it

nale romë. Projekti i UNDP-së “Fuqizimi i Komuniteteve Vendore Vulnerabël në Shqipëri” mbështeti një panair me objekte artizanale të punuara nga artizanë rom nga mbarë vendi. Qëllimi i panairit ishte fuqizimi i rrjetit të artizanëve romë si dhe mbështetja për gjetjen e tregut për produktet e tyre në Shqipëri, duke ndërthurrur një shumëllojshëm produktesh të artizanatit rom, të prodhuara me materiale të ndryshme si: letër, fibër, qelq, metal dhe pambuk. Panairi tërhoqi vëmendjen e shumë kalimtarëve dhe ishte një mundësi e mirë për artizanët romë që të shisnin produktet e tyre unike, ndërkohë që rrit ndërgjegjësimin për kontributin që jep komuniteti rom në jetën kulturore të vendit.

USAID zhvillon sipërmarrjen në turizëm

Më 14 prill 2011, Ministria e Turizmit dhe Shoqata e Investitorëve të Huaj në



Foto: USAID-i sponsorizoi stendat e dy shoqatave të turizmit dhe të dy shoqatave të teknologjisë së informacionit, për të promovuar pjesëtarët e shoqatave të tyre si dhe për zhvillimin e takimeve mes bizneseve.

Shqipëri (FIAA) sponsorizuan edicionin e dytë të Konferencës dhe Ekspozitës për zhvillimin e turizmit dhe pasurive të patundshme në Shqipëri, “TREALBEXPO 2011”. Qëllimi i eventimentit ishte të theksohej rëndësia e turizmit për ekonominë shqiptare dhe e tërhoqte së më tepër investimeve të huaja në sektorin e turizmit. USAID po mbështet sipërmarrjet shqiptare në fushën e turizmit si për shembull: duke i ndihmuar në përcaktimin e standardeve të cilësisë për hotelet dhe krijimin e mundësive të reja për bizneset e turizmit. USAID sponsorizoi stendat e dy shoqatave të turizmit dhe të dy shoqatave të teknologjisë së informacionit gjatë panairit, për të promovuar pjesëtarët e shoqatave të tyre si dhe për zhvillimin e takimeve mes bizneseve.

Mbi 100 delegatë morë pjesë në diskutimet e konferencës që theksoi nevojën për të përmirësuar klimën e biznesit dhe rolin e rëndësishëm të partneriteteve publik-privat. Pjesëmarrësit propozuan masa specifike për të përmirësuar turizmin, mjedisin e bizneseve që merren me turizmin (kuadri ligjor turistike, aktet qeveritare dhe tatimet) si edhe mundësitë për të shfrytëzuar pasuri të paluajtmshme për turizmin.



Foto: Një kalimtare në panairin e artizanëve romë në parkun Rinia.



■ Foto: Kampi rajonal i restaurimit i hapur nga "Trashëgimia Kulturore pa Kufi" më 25 prill deri më 7 maj, mirëpritëti 36 pjesëmarrës nga Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Franca, Greqia, Italia, Kosova, Rumania dhe Serbia.

Trashëgimia Kulturore pa Kufi organizon kamp rajonal restaurimi në Gjirokastrë

"Trashëgimia Kulturore pa Kufi" e financuar nga SIDA hapi kampin e gjashtë rajonal të restaurimit në Gjirokastrë nga data 25 prill deri më 7 maj 2011. Shefja e SIDA-s, Britta Olofsson vizitoi kampin e restaurimit në ditën e hapjes dhe përgëzoi "Trashëgiminë Kulturore pa Kufi" për nismën dhe të gjithë studentët për përpjekjet e tyre. Qëllimi i kampit të restaurimit është të rrisë nivelin profesional të restauruesve të rinj nga rajoni, si vajza ashtu edhe djem, përmes praktikës së punës si edhe krijimi i një rrjeti rajonal profesionistësh. Në këtë kamp morën pjesë rreth 50 studentë nga 9 shtete. Veprimtaria u realizua në bashkëpunim me partnerët akademikë: Universiteti POLIS - Shkolla Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe Politikave të Zhvillimit Urban, si edhe Fakulteti i Filologjisë dhe Historisë, departamenti për studime pasuniversitare në "Administrimin e Trashëgimisë Kulturore", Tiranë. Pak kohë më parë, në kamp erdhi Akademia Mbretëria e Arteve të Bukura në Stokholm, Suedi. Pjesëmarrësit në kamp ishin nga Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Bullgaria, Franca, Greqia, Italia, Kosova, Rumania dhe Serbia. Shumica e tyre ishin profesionistë të rinj që ndiqnin studime pasuniversitare në universitetet përkatëse në Serbi, Bullgari, Itali dhe Greqi.

Gjatë kampit, të gjithë pjesëmarrësit përdorën materialet dhe teknikat tradicionale dhe dy prej zonave të konservimit u përdorën si vend për trajnimin praktik. Ushtrimet praktike shoqëroheshin me leksione të prezantuara prej konsulentëve nga Suedia, Mbretëria e Bashkuar, Bosnja-Hercegovina, Mali i Zi, Shqipëria dhe Italia. Leksionet teorike njohën pjesëmar-

rësit me drurin dhe gurin si materiale të strukturave historike, metodat e ruajtjes së gurit, drurit, llaçit dhe suvasë, tipologjinë e arkitekturës shqiptare dhe vlerat e përbashkëta, si edhe përfaqesat gjinore në studimin e monumenteve historike.

"Trashëgimia Kulturore pa Kufi" po punon në Shqipëri me projektin "Gjirokastra 2009-2011" në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Institutin e Monumenteve të Kulturës, autoritetet vendore dhe OJF vendore. Ky projekt fokusohet në restaurimin dhe trajnimin në zonën e Gjirokastrës që mbrohet nga UNESCO-ja, ku dy monumente kombëtare, godina banimi të shekullit XIX që ishin tërësisht të braktisura, do të restaurohen plotësisht deri në fund të vitit 2011. Për më tepër, dy shtëpitë do të rijetëzohen përmes funksioneve të reja që do t'i mundësojnë pronarëve stimuj ekonomikë për të administruar dhe mirëmbajtur shtëpitë.


"Trashëgimia Kulturore pa Kufi" është organizatë suedeze që merret me ruajtjen e monumenteve të kulturës në rrezik zhdukjeje nga lufta apo neglizhenca.

USAID lançon programin Marka e Cilësisë Authentic Albania në mbështetje të Bizneseve të Turizmit në Shqipëri

Më 29 prill 2011, programi i USAID-it Rritje Albania, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si dhe Shoqata e Turizmit Shqiptar (ATA), përruan një program të ri në mbështetje të industrisë së turizmit shqiptar që ka njohur rritje vitet e fundit. Programi i Markës së Cilësisë *Authentic Albania* mbështet biznese të sektorit të turizmit në Shqipëri duke ndërtuar një sistem që ofron stan-



■ Foto: Drejtori i misionit të USAID-it në Shqipëri, Z. Joseph C. Williams, Ministria e Turizmit në Detyrë, Znj. Suzana Turku, dhe Kryetari i Shoqatës Shqiptare të Turizmit, z. Enver Mehmeti, në ceremoninë e shpërndarjes së Çmimeve 20 hoteleve të para



për të lançuar nismën më të fundit për promovimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore vendase. Në këtë eveniment u prezantuan mbi 20 produkte të ndryshme me etiketimin “Albanian Guarantee”, të cilët do të gjejnë rrugën drejt tregut.

Evenimenti i organizuar nga projekti zviceran “Mbështetja për Bujqësinë e Integruar në Shqipëri” shënoi fazën e fundit të përpjekjeve të projektit për të zgjeruar mundësitë e tregut për produktet shqiptare. Mes produkteve të lançuara ishin fruta, perime, mjaltë, vaj ulliri, marmelatë dhe produkte baxhoje, të gjitha të cilësisë së lartë. U krijuan dy logo origjine: “Prodhime Jugu” për produktet e prodhuara në jug të vendit, dhe “Alpe Albania” për produktet që vi-

jnë nga veriu. Etiketa “Albanian Guarantee” i tregon konsumatorit origjinën e produktit dhe i garanton se janë përdorur praktika të shëndetshme dhe të sigurta. “Në mendjen time, e imagjinoj ushqimin shqiptar të shijshëm, të freskët dhe të shëndetshëm”, tha Ambasadorja zvicerane Yvana Enzler. “Etiketimi Albanian Guarantee i ideuar nga projekti synon të krijojë këtë pamje në mendjen e të gjithëve”, u shpreh Ambasadorja. Për të lehtësuar hyrjen në treg, produktet do të prezantohen në supermarketin Mercator dhe në disa dyqane pakice në Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër dhe në aeroportin e Rinasit. Evenimenti shënoi një hap të rëndësishëm në promovimin e prodhimit bujqësor shqiptar të cilësisë së lartë.

darde të cilësisë për hotelet dhe u ofron bizneseve mundësi të reja për zhvillim. Ky program do të jetë i pari i këtij lloji që vlerëson cilësinë e njësive akomoduese në Shqipëri. Drejtori i misionit të USAID-it në Shqipëri, Z. Joseph C. Williams, Ministrija e Turizmit në Detyrë, Znj. Suzana Turku, dhe Kryetari i Shoqatës Shqiptare të Turizmit, z. Enver Mehmeti, mbajtën fjalë përsëritëse në ceremoninë e shpërndarjes së Çmimeve 20 hoteleve të para që marrin markën e cilësisë Authentic Albania.

Tre çmimet e *Authentic Albania*: i Artë, i Argjendtë dhe i Bronztë u përcaktuan në bazë të markës së cilësisë Authentic Albania i cili vlerëson njësitë akomoduese në shtatë dimensione kyçe, të cilat së bashku reflektojnë kërkesat e udhëtarëve për profesionalizëm, siguri, pastërti dhe rehati, si edhe nxisin praktikatat e turizmit të qëndrueshëm. Vlerësimet u kryen nga një grup vlerësuesish të pavarur të trajnuar nga ekspertë ndërkombëtarë për Kuadri i Markës së Cilësisë. Rezultatet e vlerësimeve u shqyrtuan nga një Komitet Çmimesh i përbërë nga anëtarë nga organizata qeveritare, donatorë, institucione akademike dhe shoqëria civile. Për informacione të mëtejshme rreth programit, lutemi vizitoni faqen e internetit USAID/Albania.

Projekti zviceran promovon Ushqimet dhe Produktet Bujqësore të cilësisë së lartë të prodhuar në Shqipëri

Më 15 prill 2011, prodhuesit, përpunuesit, shitësit me pakicë dhe ofruesit e shërbimeve të biznesit shqiptar zhvilluan një takim në Hotel Tirana International



Foto: Punimet e tryezës së rumbullakët me temë “Zhvillimet Potenciale të Industrisë së Veshjeve në Shqipëri”, organizuar nga Dhoma e Fasonistëve të Shqipërisë në bashkëpunim me METE dhe me mbështetjen e GIZ EDEP

Potencialet e zhvillimit të industrisë së veshjeve në Shqipëri

Programi i GIZ “Mbështetja e Zhvillimit Ekonomik dhe Nxtija e Punësimit” (Economic Development and Employment Promotion in Albania - EDEP), ndër sektorë të ndryshëm mbështet edhe industrinë e veshjeve. Rritja e konkurrencës së ndërmarrjeve shqiptare të fasonit, krijimi

i ciklit të mbyllur, zhvillimi i koleksioneve dhe partneriteti me kompani gjermane në industrinë e veshjeve janë ndërhyrjet kyce në të cilat është fokusuar programi. Dhoma e Fasonistëve të Shqipërisë në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës si dhe me mbështetjen e



Foto: Punimet e tryezës së rumbullakët me temë “Zhvillimet Potenciale të Industrisë së Veshjeve në Shqipëri”, organizuar nga Dhoma e Fasonistëve të Shqipërisë në bashkëpunim me METE dhe me mbështetjen e GIZ EDEP

GIZ EDEP organizuan ne 14 Prill 2011 tryezën e rrumbullakët me temë “Zhvillimet Potenciale të Industrisë së Veshjeve në Shqipëri”, një dialog të hapur mbi zhvillimet potenciale të industrisë së veshjeve në Shqipëri dhe mundësitë e investimeve për të ardhmen. Duke konsideruar interesin në rritje të kompanive gjermane për industrinë shqiptare të veshjeve, përfaqësues të kompanive gjermane ishin të ftuar në këtë takim. Kriza në vendet e lindjes se mesme si dhe rritja e kostove të vazhdueshme në Europë ka nxitur industrialistët e huaj të kërkojnë partnerë në rajon, sidomos në Shqipëri duke konsideruar edhe nivelin konkurrues të pagave. Të dhënat e INSTAT konfirmojnë se eksportet e tekstileve dhe këpucëve ndaj gjermanisë janë rritur vazhdimisht nga viti 2007 në vazhdim. Ekspertër gjermanë vunë në dukje se industria e fasonit në Shqipëri ka sot ndër kostot më të ulëta të fuqisë punëtore në të gjithë rajonin 0.06 – 0.07 euro/minutë. Ndër të tjera u theksua që kompanitë shqiptare të fasonit duhet të vijojnë të investojnë në industri/teknologji dhe mbi të gjitha të organizohen së bashku në formën e një clusteri për të përballuar porosi dhe kërkesa të mëdha që mund të vijnë nga kompani europiane. Një element shumë i rëndësishëm ku duhet të zhvillohen kompanitë është edhe tregu vendas. Ndërmarrjet duhet të kenë prioritet orientimin ndaj tregut vendas dhe furnizimin e tij me veshje sepse kanë mundësi të forta të konkurojnë importet nga Europa – vunë në dukje përfaqësuesit Gjermanë. Kompania Logwin e cila operon mjaft suksesshëm në rajon duket se do të ketë destinacion të fundit Shqipëri-në. Vetëm në Maqedoni kjo kompani furnizon me porosi thujt gjysmën e ndërmarrjeve të fasonit dhe gjithashtu rreth 27,000 të punësuar. Pritet që kjo kompani të fillojë së shpejti aktivitetin e saj në Shqipëri.

Aktivitet promovues i Albanian Software Cluster

Programi i GIZ “Mbështetja e Zhvillimit Ekonomik dhe Nxtija e Punësimit” (Economic Development and Employment Promotion in Albania - EDEP), ndër sektorë të ndryshëm mbështet edhe industrinë e software-it. Programi implementon një përfaqësim të integruar duke synuar përmirësimin e konkurrueshmërisë së kompanive të IT dhe të software-it. Në qendër të promovimit të industrisë shqiptare të software-it, qëndron Cluster-i Shqiptar i Software-it (Albanian Software Cluster – ASC), i cili ka si qëllim primar promovimin e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve kryesorë të



Foto: Aktivitet promovues organizuar nga ASC në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Tiranës dhe me mbështetjen e GIZ

industrisë shiptare të software-it (sektorit privat, sektorit publik, insitucioneve akademike/universiteteve). Një nga aktivitetet dhe qëllimet e Clusterit, është edhe kualifikimi i burimeve njerëzore të ardhshme për firmat shqiptare të software-it, të cilat përcaktojnë cilësinë, kapacitetin si dhe konkurrueshmërinë e industrisë së IT-së. Për këtë arsye Akademia e Trajnimeve të Cluster-it Shqiptar të Software-it, në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Tiranës dhe me mbështetjen e GIZ EDEP, ka organizuar një seri trajnimesh dhe mbi 35 persona (përfaqësues të administrates shtetërore, përfaqësues të kompanive shqiptare të software-it, student, etj), janë kualifikuar. Në 15 Prill 2011, ASC në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Tiranës dhe me mbështetjen e GIZ EDEP organizuan një aktivitet promovues për shpërndarjen e certifikateve si dhe prezantimin e faqes së internetit të ASC. Një moment i rëndësishëm i këtij takimi ishte edhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Cluster-it Shqiptar të Software-it dhe projektit USAID-it’s Rritje Albania/Zhvillimi i Ndërmarrjeve Konkuruese.

Grupi i Fakultetit Juridik të Tiranës merr pjesë në Pre-moot në Beograd

Në kuadrin e Fondit të Hapur Rajonal për Evropën Juglindore - Reformës Ligjore (ORF-LR), është krijuar komponenti për zbatimin rajonal të metodave për zgjidhjet alternative të mosmarrëveshjeve. Ky komponent është përgatitur në bashkëpunim me UNCITRAL dhe Institucionin Gjerman për Arbitrazhin (DIS - Deutsche Institution für Schiedsgerichtsbarkeit e.V.). Edhe pse në shumicën e vendeve ekzistojnë metodat për zgjidhjet alternative të

mosmarrëveshjeve, zbatimi i tyre mbetet i dobët, sidomos në fushën e ekonomisë. Biznesi dhe ekspertët juridikë nuk kanë përvijën e mjaftueshme me këto metoda. Për të mbështetur edukimin në këtë fushë, si dhe për t’u bërë faktor në përmirësimin e shkallës së zbatimit, komponenti mbështeti dhe organizoi Gjykatën Pre-Moot në Beograd, në bashkëpunim me Fakultetin e Juridikut. Ky eveniment zhvillohet për herë të katërt (pasi tre evenimentet pre-moot të mëparshme u mbështetën në kuadrin e Komponentit për Konventën për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave). Gjykata Pre-moot synon të rrisë përvijën e pjesëmarrësve në përgatitje për konkursin ndërkombëtar në Vjenë, në Gjykatën (e inskenuar) të Arbitrazhit Ndërkombëtar Tregtar Willem C. Vis. Në vitin 2011 morën pjesë 262 universitete nga mbarë bota. Në këtë raund paraprak morën pjesë 31 skuadra nga 22 vende (Shqipëria, Austria, Bosnjë-Hercegovina, Brazili, Ishujt Kajman, Kroacia, Gjermania, Britania e Madhe, India, Italia, Maqedonia, Mali i Zi, Zelanda e Re, Polonia, Uruguai, Rusia, Serbia, Koreja e Jugut, Spanja, Zvicra, Turqia dhe SHBA-ja), duke bërë që ky raundi i 2011-ës të ketë pjesëmarrjen më të gjerë. Përvoja edukative që ofron Gjykata Pre-moot e Beogradit ka ardhur në rritje që nga viti 2009. Tashmë ajo ka një konferencë arbitrazhi ndërkombëtar që mbahet çdo ditë para gjyqit të inskenuar. Të gjithë studentët, profesorët dhe gjyqtarët e arbitrazhit ftohën për të marrë pjesë falas. Në konferencën e zhvilluar sivjet morën pjesë rreth 450 vetë (për herë të parë ishin rreth 50 gjyqtarë që zakonisht nuk marrin pjesë në konferencë pasi humbasin shumë kohë të çmuar që u duhet për t’u marrë me çështjet e tyre). GIZ nuk arrin të mbështesë këtë zgjerim vetëm. Për shembull, sivjet nevojiteshin 145 gjyqtarë arbitrazhi nga 20 shtete. Edhe këtë herë kishim bashkëpunuesorë dhe mbështetës, si për shembull Min-

istria serbe e Bujqësisë, Tregtisë, Pylltarisë dhe Administrimit të Ujërave (konferencën e hapi ministri), Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Gjykatën e Arbitrazhit për Tregtinë e Huaj (që ka lidhje me Dhomën Serbe të Tregtisë), Bashkia e Beogradit, ICC (që është institucioni më i rëndësishëm për arbitrazhin tregtar), Shkolla Queen Mary e Arbitrazhit Ndërkombëtar, Bashkëpunimi Financiar Ndërkombëtar (IFC), Ambasada e Vendeve të Ulëta, Organizata e Turizmit e Beogradit, disa studio ligjore si Karanovic - Nikolic, White & Case, Wilmer Hale, Moravcevic Vojnovic Zdravkovic (në bashkëpunim me Schönherr), Bojovic, Dasic dhe Kojovic. Me qëllim që të përfitohet përvoja e gjerë e të gjithë rajonit në konferencë dhe në gjyqin e inskenuar, GIZ organizoi edhe një diskutim ku u diskutuan zhvillimet më të fundit në fushën e zgjidhjeve alternative të arbitrazhit si edhe veprimtarive e mundshme për të ardhmen. Në këtë tryezë të rrumbullakët ishin të pranishëm edhe partnerët tanë, UNCITRAL dhe DIS.



Foto: Të kthyerit marrin pjesë në konferencën e Shkodrës më 29 prill 2011, ku bëhet shpallja e parë për projekt-propozime në kuadrin e projektit "Risorse Migranti".

Grant për sipërmarrjet mikro në Shkodër dhe Lezhë

Projekti "Risorse Migranti/Migrantët për Zhvillim" i bashkëfinancuar nga Ministria italiane e Punëve të Jashtme dhe e zbatuar nga OJF-të IPSIA ACLI dhe Caritas Italiana, ka shpallur grantin 5 175 000 lekë për të kthyerit që duhet të paraqesin projekte mikro në rrethet e Shkodrës dhe Lezhës. "Risorse Migranti / Migrantët për Zhvillim" synon të forcojë dhe të zhvillojë aftësitë profesionale dhe ndërpersonale që të kthyerit kanë përfutur gjatë përvojës jashtë shtetit, sidomos në Itali. Gjatë vitit 2010, projekti konsolidoi aftësitë profesionale të migrantëve të mëparshëm përmes kurseve profesionale orientuese dhe edukuese si edhe seancave autoriale se si përgatitet një plan biznesi dhe si fillohet një aktivitet ekonomik. Për vitin 2011, projek-



Foto: Staf i projektit IPSIA në takim me përfaqësues të institucioneve të Shkodrës dhe Lezhës duke përcaktuar veprimtaritë e projektit.

ti do të ndihmojë të kthyerit që do të hapin sipërmarrje mikro ose projekte individuale që merren me prezantimin e planeve të biznesit. Projektet më të mira sipërmarrëse do të fitojnë tri shpallje publike për tender: e para është prezantuar më 19 prill 2011, e dyta do të lançohet pas verës dhe e fundit në vjeshtë ose dimër 2011. Aplikimet për shpalljen e parë duhet të dorëzohen brenda afatit 2-31 maj 2011 dhe përfituesit e grantit do të njoftohet pas 15 korrikut 2011. Nga kriteret e vlerësimit, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet qëndrueshmërisë ekonomike të projekteve, novacionit, aftësisë për të gjeneruar të ardhura dhe punësim, impakti social dhe mjedisor, konsistenca mes investimeve të kërkuara dhe

objektivave të ndërmarrjes, pjesëmarrja në trajnimet e mëparshme të këtij projekti si dhe sukcesi potencial në treg. Fondi grant maksimal është 1.035 milion lekë për një projekt, por kjo shumë duhet të përbëjë jo më shumë se 70% të vlerës totale të projektit. Si donator kryesor evropian për zhvillimin e sektorit privat në Shqipëri, Kooperacioni Italian për Zhvillim mbështet dhe mirëpret nismat e OJF-ve që nxisin hapjen e bizneseve të reja dhe mbështet ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.

PAMECA III Menaxhimi i Kufirit Blu Trajnim për Institucionet që bashkëveprojnë me QNOD

Për zbatimin e strategjisë së trajnimit të QNOD-së (Qendra Ndër-institucionale Operacionale Detare), PAMECA mbështeti organizimin dhe ofrimin e dy kurseve trajnuese në mjediset e Drejtorisë së Përgjithshme Detare në Durrës. Pjesëmarrës ishin përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit - Drejtoria e Mjedisit dhe Peshkimit, Ministria e Mbrojtjes - Roja Detare dhe Forcat Ajrore, Ministria e Brendshme - Policia e Kufirit dhe Migrimit, Ministria e Financave - Drejtoria e Përgjith-



Foto: Trajnim mbi menaxhimin e kufirit blu për institucionet që bashkëveprojnë me QNOD-në

shme e Doganave, Ministria e Publike dhe Transportit - Drejtoria e Përgjithshme Detare dhe personeli i Drejtorisë Administrative të QNOD-së. Kursi i parë me 23 pjesëmarrës u zhvillua në periudhën 28 mars - 1 prill me temë: “E drejta Detare - Kuadri Rregullator Detar Kombëtar dhe Ndërkombëtar”. Në këtë kurs u prezantua e drejta detare, Kuadri Juridik Detar Ndërkombëtar dhe kuadri rregullator detar shqiptar. Edhe kursi i dytë kishte 23 pjesëmarrës dhe u zhvillua në datat 21-28 prill dhe u fokusua në Operacionet e Kërkimit-Shpëtimit në Det. Kursi u përqendrua në sistemin ndërkombëtar të kërkim-shpëtimit në det, planifikimin dhe zhvillimin e operacioneve, mes të tjerash. Instruktori i kurseve ishte z. Rodrigo Garcia, i ftuar dhe i mbështetur nga PAMECA III. Pjesëmarrësit u shprehën se përfituan mjaft njohuri nga përvoja dhe praktika ndërkombëtare, si edhe nga ndërveprimi me pjesëtarë të institucioneve kombëtare të tjera, çka u mundësoi të kuptonin punën dhe përgjegjësitë e kolegëve. Njohuritë dhe kontaktet e reja do të ndihmojnë në përmirësimin e përdorimit të burimeve dhe të bashkërendimit në të ardhmen.

USAID mbështet Ndërmjetësimin në Gjykata në Shqipëri

Më 22 prill 2011, Programi i USAID për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri (JuST) nënshkroi një marrëveshje me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe me Fondacionin Shqiptar “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve” (FZK), me synim mbështetjen dhe shtrirjen e mëtejshme të programit të ndërmjetësimin në Durrës, si një mënyrë alternative ndaj zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në gjykatë. Që prej shkurtit 2009, FZK-ja me mbështetjen nga Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC), ofron shërbime ndërmjetësimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Me këtë marrëveshje, USAID do të mbështetë FZK të futë dhe të zbatojë metodën e ndërmjetësimin në çështjet gjyqësore të së drejtës familjare dhe të vazhdojë të ofrojë shërbime ndërmjetësimi për çështje tregtare. Në ceremoni morën pjesë edhe Drejtori për Projektet në Misionin e USAID-it, Andrew Maybrook, Zëvendësministria e Drejtësisë, Brikena Kasmi, dhe anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ilir Mustafaraj.



Foto: Projekti JuST i USAID-it nënshkroi marrëveshje me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe me Fondacionin shqiptar “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”

Sipas Zëvendësministres, ndërmjetësimi në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përbën një aspekt të rëndësishëm të reformave dhe masave me efekte pozitive në funksionimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Ligji aktual për ndërmjetësimin, i cili ka hyrë në fuqi në datën 9 prill 2011, i ngarkon Ministrinë së Drejtësisë përgjegjësinë e krijimit dhe mbajtjes së Regjistrimit të Ndërmjetësve, si dhe parashikon ngritjen e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve. Ligji përfshin detyrimin që gjyqtarët të ftojnë palët në çështje gjyqësore që t’i zgjidhin ato me ndërmjetësim, duke ofruar në këtë mënyrë një instrument të rëndësishëm në marrjen e shpejtë të vendimeve dhe rritjen e transparencës në gjykatë.

JuST është një program pesëvjeçar i USAID-it që synon rritjen e transparencës, paanshmërisë dhe efektshmërisë në gjykata, konsolidimin e rolit mbikëqyrës dhe anti-korrupsion të organizatave të shoqërisë civile dhe medias, si dhe forcimin e arsimit juridik dhe avokatisë në Shqipëri. Deri në përfundimin e këtij projekti në 2015, USAID-i do të krijojë dhe mbështesë tre programe ndërmjetësimi në Shqipëri.

Arbitrazhi Ndërkombëtar

Neni 439 i Kodit të Procedurës Civile parashikon që nga viti 1994 se arbitrazhi ndërkombëtar duhet të disiplinohet me një ligj të veçantë. Deri më sot, ky ligj nuk ekziston. Komponenti për zbatimin rajonal të metodave për zgjidhjet alternative të mosmarrëveshjeve, mbështet procesin e hartimit të ligjit të ri për arbitrazhin ndërkombëtar. Kjo gjë po realizohet nga

Fondi i Hapur Rajonal për Evropën Juglindore - Reforma Zgjedhore, GIZ (Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit), bashkë me UNCITRAL (Komisioni i OKB-së për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare), Institutin Gjerman për Arbitrazh dhe DIS (Deutsche Institution für Schiedsgerichtsbarkeit e.V.). Z. Renaud Sorieul, Sekretar i UNCITRAL-it, që vizitoi Shqipërinë më 11-13 prill 2011, i dha ekspertizën e tij grupit të punës të ngritur brenda Ministrisë së Drejtësisë. Me këtë rast, Ministri i Drejtësisë, z. Bujar Nishani (aktualisht Ministër i Brendshëm), theksoi se arbitrazhi ka rëndësi përcaktuese, sidomos për investitorët e huaj, dhe se ndihma në këtë drejtim çmohet shumë. Është e vërtetë që nga këndvështrimi i investitorëve të huaj, një sistem alternativ ndaj sistemit të gjykatave kombëtare është mëse i mirëpritur, për shkak të mungesës së besimit të gjyqësori, ose për shkak të vështirësive që hasin në këtë sistem.

Aktualisht, edhe rregullat për arbitrazhin kombëtar po përgatiten nga një grup pune, pasi rregullat e arbitrazhit ndërkombëtar mund të përdoren edhe për arbitrazhin kombëtar; kjo do t’ua lehtësonte jetën aktorëve juridikë, pasi kështu nuk do të ketë disa regjime rregullatore, si për arbitrazhin kombëtar edhe atë ndërkombëtar. Procesi udhëhiqet nga zv.Ministria e Drejtësisë, znj. Brikena Kasmi. Edhe pse arbitrazhi është një formë “drejtësie private”, bazohet te sistemi gjyqësor, p.sh. për sa i përket ekzekutimit të vendimeve. Për këtë arsye, z. Renaud Sorieul dha një leksion për arbitrazhin studentëve të vitit të parë dhe të dytë në Shkollën e Magjistraturës, sepse ata janë gjyqtarët e ardhshëm të Shqipërisë.

Banka Botërore

Një mision mbikëqyrës i Bankës Botërore për Projektin e Modernizimit të Sistemit Shëndetësor vizitoi Shqipërinë nga 18 deri në 23 prill 2011. Qëllimet kryesore të misionit ishin: të vëzhgonin ecurinë e zbatimit të projektit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë aktiviteteve të mbetura; të mbante bisedime të ngushta dhe të arrinte një marrëveshje përfundimtare me Ministrinë e Shëndetësisë, Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe me Kryeministrinë për zhvillimin e aktiviteteve për teknologjinë e informacionit në Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor; të analizonin shifrat e buxhetit, me qëllim që të përdoren të gjitha fondet e projektit brenda datës së mbylljes që është 31 marsi 2012; dhe të bënte vizita në terren për të parë funksionimin e pajisjeve mjekësore të blera me fondet e projektit.

Më 11-13 prill 2011 erdhi në Shqipëri një mision i Bankës Botërore për të ndjekur Projektin për Përmirësimin e Raportimit Financiar të Shoqërive (CFREP) dhe Rruga drejt Evropës: Programi i Reformës në Kontabilitet dhe Fuqizimit Institucional (REPARIS). Misioni që ishte pjesë e lançimit të projektit CFREP, vëzhgoi edhe përgatitjet për fazën e re të REPARIS (2012-2016) që do të financohet nga Bashkimi Evropian përmes Instrumentit IPA me Shumë Përfitues. Me aspiratën për të aderuar në BE, Shqipëria po forcon kuadrin dhe praktikën për transparencën dhe përgjegjshmërinë e sektorit të biznesit, duke i sjellë ato në përputhje me *acquis* të BE-së. Që në vitin 2009, Qendra e OKB-së për Reformën në Raportimin Financiar ka ndihmuar përpjekjet e Shqipërisë përmes programit Rruga drejt Evropës (REPARIS) i financuar kryesisht nga qeveria austriake. Shqipëria ka përfutur nga një CFREP i financuar prej REPARIS-it, falë kontributit të qeverisë zvicerane.

Në datat 8 deri më 8 prill 2011, erdhi në Shqipëri misioni i Bankës Botërore për Projektin e propozuar të Shërbimit Global Mjedisor (GEF) - Mbështetje për Nismën Rajonale të Ballkanit Perëndimor për Përmbytytjet dhe Thatësira. Qëllimi kryesor i misionit ishte të diskutonte me strukturat e qeverisë shqiptare për projektin e mundshëm, fushën e veprimtimit dhe veprimtaritë e kësaj nisme rajonale të mbështetur nga GEF, me synimin për të promovuar menaxhimin e integruar ndërkufitar të baseneve lumore, përfshi mbrojtjen nga përmbytytjet, kapa-

Misionet në vend

citetet për paralajmërimin e hershëm për përmbytytjet, zbutjen e thatësirës dhe menaxhimin e ekosistemit. Nisma do të fokusohet në basenet lumore të Drinës dhe Drinit dhe do të përfshijë Bosnjë-Hercegovinën, Malin e Zi, Shqipërinë dhe Serbinë.

Një mision i Bankës Botërore për Projektin "Modernizimi i Asistencës Sociale në Shqipëri" u zhvillua nga 26 prilli deri më 6 maj 2011. Qëllimet kryesore të misionit ishin që të diskutonte me palët homologe: Projektin e propozuar për Modernizimin e Asistencës Sociale që do të ndihmojë në përmirësimin e programeve të asistencës sociale (programet e invaliditetit dhe ndihma ekonomike); përmirësimin e administrimit të benefiteve për programet e asistencës sociale (administrimi i sistemeve të informacionit, proceset e pagimit, sistemet e monitorimit) dhe zgjerimet e mundshme për të lidhur përfituesit me kapitalin njerëzor dhe/ose stimuj aktivizimi; dhe fillimi i punës me reformat e invaliditetit, pasi të bëhet Vlerësimi i Varfërisë dhe Impaktit Social (PSIA), që do të mbështeten nga Projekti i propozuar për Modernizimin e Asistencës Sociale. Përveç këtyre, misioni kishte për qëllim edhe: (i) Prezantimin e një for-

mule të re pikësh për ndihmën ekonomike, (ii) Diskutimin e Zbatimit të fazës pilot të formulës së pikëve, (iii) të fillojë puna me analizën PSIA, (v) dhe Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale.

Misioni i identifikimit për projektin e propozuar "Huaja e Parë për Politikën e Rritjes dhe Zhvillimit të Konkurrueshmërisë (DPL1) u zhvillua më 26-29 prill 2011. Misioni kryesohej nga ekonomistët Borko Handijski dhe Erjon Luçi dhe përfshinte Doyle Gallegos (ICT), Gentjana Sula (arsim), Artan Guxho (ujërat), Gazmend Daci (energji), Ibrahim Haçkaj (bujqësia), Evis Sulko (të drejtat e pronësisë dhe menaxhimi financiar publik). Krye-ekonomisti Ron Hood iu bashkua misionit për të dhënë mbështetje dhe orientim strategjik. Qëllimi i misionit ishte që bashkë me qeverinë shqiptare të evidentohen politikën kyçe dhe masat kryesore në fushat e mësipërme (Teknologjia e Komunikimit dhe Informacionit, arsimit, ujërat, energjia, bujqësia, të drejtat e pronësisë dhe menaxhimi financiar publik) që të përfshihen në nismën e propozuar, si edhe të bihet dakord për afatet kohore për përgatitjen e DPL1-shit.

dialoguqeveridonatorë

Nga data 15 dhjetor 2010 Banka Botërore mori Kryesimin e Sekretariatit Teknik të Donatorëve nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim.

Të gjitha komentet lidhur me Dialogun Qeveri-Donatorë janë më se të mirpëritura!

Doni të kontribuoni?

Nëse dëshironi të kontribuoni, dërgoni tekstin tuaj në zyrën e Sekretarit Teknik të Donatorëve (nevila.com@aidharmonisation.org.al) ose në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (koordinimi@km.gov.al) deri më datë 5 të çdo muaji. Teksti duhet të jetë mundësisht rreth 100 fjalë.

Shpërndarja:

Çdo botim do t'ju dërgohet më datë 15 të çdo muaji.

Cilët janë donatorët në Shqipëri?

Për të zbuluar cilët janë donatorët që operojnë në Shqipëri, klikoni [këtu](#).

Për t'u çregjistruar:

Lutemi dërgoni e-mail tek Nevila Çomo (nevila.com@aidharmonisation.org.al)

Buletini "Dialogu Qeveri-Donatorë" mbështetet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

